

Konkluzion operacional i grupit punues për Diplomat Bruksel, 21 mars 2016

- 1) Palët informuan njëra-tjetrën për procedurat e tyre përkatëse për njohjen e diplomave të Institucionit të Arsimit të Lartë për përdorim profesional dhe akademik, diplomat për shkolla fillore, të mesme dhe trajnime profesionale dhe për diplomë të nivelit të pestë të kualifikimit, sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe për doktoraturë (PhD).
- 2) Palët bien dakord të respektojnë plotësisht afatet / tarifat e përcaktuara në konkluzionet e janarit 2016
- 3) Palët bien dakord që të gjitha diplomat EUA të certifikuara më parë të dorëzuara për njohje do të fillojnë të procesohen duke filluar nga 4 prill 2016 dhe procedurat e njohjes do të përfundojnë në përputhje me afatet e përcaktuara në konkluzionet nga janari 2016.
- 4) Palët kanë dorëzuar tek kryesuesi i BE-së listën përkatëse të Institucioneve të akredituara të Arsimit të Lartë. Kryesuesi i BE-së do t'i ndajë ato me palët
- 5) BE-ja do të ecë përpara me projekt(e) për të zgjedhur partnerët implementues (për certifikimin dhe qëllime administrative) dhe do t'i mbajë palët të informuara për progresin.
- 6) Në ndërkohë, ministritë përkatëse nga palët do të mbledhin aplikacionet për njohjen e diplomave duke filluar nga 4 prilli 2016 dhe do t'i dorëzojnë ato tek partnerët implementues/administrativ të zgjedhur më herët. Palët do t'i dërgojnë e-mail adresat relevante sa më herët që është e mundur. BE-ja do të lëshojë një komunikata për shtyp përmes përfaqësive të tyre në Beograd dhe Prishtinë, për të informuar opinionin.
- 7) Palët ranë dakord për Termat e Referencës në vijim të Grupit Trepalësh për Implementimin - GTI:
 - Grupi aktual i punës për diplomat do të veprojë si GTI.
 - GTI do të kryesohet nga BE-ja dhe do të takohet së paku dy herë në vit ose më shpesh me kërkesë të palëve.
 - GTI do të monitorojë zbatimin e marrëveshjeve mbi diplomat dhe konkluzionet mbi njohjen e ndërsjellë të diplomave në bazë të marrëveshjeve origjinale nga viti 2011.
 - Partneri implementues/administrativ, në bashkëpunim me ministritë përkatëse nga të dyja palët do të raportojë rregullisht në GTI në lidhje me numrin e aplikacioneve për njohje të dorëzuara, certifikuara, të dhëna dhe të refuzuara, me arsyet për refuzim, të paktën çdo gjashtë muaj
 - GTI do të ketë të drejtë të kërkojë informata në lidhje me rastet e kontestuara.
 - GTI mund të propozojë masa për të zgjidhur mosmarrëveshjet e mundshme në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve dhe konkluzionet / mund të sugjerojnë mjetet adekuate.